



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALLAKASTËR
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Nr. _____ Prot.

Ballsh, më ____ . ____ . 2023

Lënda: **Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)**

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK - TIRANË
(për publikim në SPE dhe buletin e njoftimeve publike)

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)
BASHKIA MALLAKASTËR

Data 03.07.2023

Drejtuar: Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE): **“K.M.K” shpk**, me NIPT L78223801E & **“CAUSHI M” shpk**, me NIPT L88419801O, përfaqësuar nga **“K.M.K” shpk**, me adresë qendrore sipas QKB: Bulevardi **“Rrapo Hekali”**, Shkalla 1, Kati 1, Z.Kadastrale 1090, Ballsh

* * *

Procedura e prokurimit: **“E hapur”**

Numri i referencës së procedurës: **REF-65827-04-12-2023**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Rikonstruksion i rrugës Panahor-Ngraçan (segmenti Panahor-Subashaj) dhe rrugës Ballsh-Drenovë e Re (segmenti depo e ujit-shkolla)”**, me fond limit **78,253,438** (shtatëdhjetë e tetë milion e dyqind e pesëdhjetë e tremijë e katërqind e tridhjetë e tetë) **Lekë pa TVSH**

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike nr.53, datë 12 Qershor 2023 (publikuar formulari i njoftimit të fituesit paraprak)

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik (OE) “SHKELQIMI 07” shpk, me NIPT K68121808W, me ofertë ekonomike në shumën prej **50,000,000** (pesëdhjetëmilion) **lekë pa TVSH.**

- 2. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “2 N” shpk, me NIPT L31615017L & “INA” shpk, me NIPT J61814009W, me ofertë ekonomike në shumën prej 58,599,955 (pesëdhjetë e tetëmilion e pesëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.**
- 3. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “AIDA CONSTRUCTION” shpk, me NIPT M03116403L & “ROSI” shpk, me NIPT J69102223E, me ofertë ekonomike në shumën prej 54,200,900 (pesëdhjetë e katërmilion dyqindmijë e nëntëqind) lekë pa TVSH.**
- 4. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “ALBA KONSTRUKSION” shpk, me NIPT J61812013R & “VELLEZERIT KUKA” shpk, me NIPT J63423440Q, me ofertë ekonomike në shumën prej 58,621,945 (pesëdhjetë e tetëmilion e gjashtëqind e njëzetë e një mijë e nëntëqind e dyzetë e pesë) lekë pa TVSH**
- 5. Operatori Ekonomik (OE) “BEQIRI” shpk, me NIPT J98624801V, me ofertë ekonomike në shumën prej 61,897,900 (gjashtëdhjetë e njëmilion e tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind) lekë pa TVSH.**
- 6. Operatori Ekonomik (OE) “BIBA-X” shpk, me NIPT K32618815N, me ofertë ekonomike në shumën prej 69,065,000 gjashtëdhjetë e nëntëmilion e gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë pa TVSH.**
- 7. Operatori Ekonomik (OE) “COBIAL” shpk, me NIPT K02715414M, me ofertë ekonomike në shumën prej 72,772,000 (shtatëdhjetë e dymilion e shtatëqind e shtatëdhjetë e dymijë) lekë pa TVSH.**
- 8. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “DEHA 2010” shpk, me NIPT L03425410B & “Rroku GUEST” shpk, me NIPT K87921701H, me ofertë ekonomike në shumën prej 55,959,270 (pesëdhjetë e pesëmilion e nëntëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH.**
- 9. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “DESARET COMPANY” shpk, me NIPT K01816001J & “Rruge Sinjalistike Mirembajtje & Hidro Company” shpk, me NIPT L04803001U, me ofertë ekonomike në shumën prej 61,334,647 (gjashtëdhjetë e njëmilion e treqind e tridhjetë e katërmijë e gjashtëqind e dyzetë e shtatë) lekë pa TVSH.**
- 10. Operatori Ekonomik (OE) “GLAVENICA” shpk, me NIPT K17710805A, me ofertë ekonomike në shumën prej 68,852,390 (gjashtëdhjetë e tetëmilion e tetëqind e pesëdhjetë e dymijë e treqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH.**
- 11. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “K.M.K” shpk, me NIPT L78223801E & “CAUSHI M” shpk, me NIPT L88419801O, me ofertë ekonomike në shumën prej 49,092,600 (dyzetë e nëntëmilion e nëntëdhjetë e dymijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH.**
- 12. Operatori Ekonomik (OE) “L.T.E CONSTRUCTION” shpk, me NIPT L78006801F, me ofertë ekonomike në shumën prej 53,880,430 (pesëdhjetë e tremilion e tetëqind e tetëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë) lekë pa TVSH.**

13. **Operatori Ekonomik (OE) “LLAZO” shpk**, me NIPT K24218401K, me ofertë ekonomike në shumën prej **52,203,300** (pesëdhjetë e dymilion e dyqind e tremijë e treqind) **lekë pa TVSH**.
14. **Operatori Ekonomik (OE) “NDREGJONI” shpk**, me NIPT K31329048I, me ofertë ekonomike në shumën prej **61,900,500** (gjashtëdhjetë e njëmilion e nëntëqindmijë e pesëqind) **lekë pa TVSH**.
15. **Operatori Ekonomik (OE) “S.M.O.UNION” shpk**, me NIPT J66902042Q, me ofertë ekonomike në shumën prej **54,537,875** (pesëdhjetë e katërmilion e pesëqind e tridhjetë e shtatë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë) **lekë pa TVSH**.
16. **Operatori Ekonomik (OE) “Shendeli” shpk**, me NIPT K07924803N, me ofertë ekonomike në shumën prej **58,846,950** (pesëdhjetë e tetëmilion e tetëqind e dyzetë e gjashtëmijë e nëntëqind e pesëdhjetë) **lekë pa TVSH**.
17. **Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “TEA-D” shpk**, me NIPT K32522629L & **“COGREN” shpk**, me NIPT J74818825K, me ofertë ekonomike në shumën prej **67,670,350** (gjashtëdhjetë e shtatëmilion e gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë e treqind e pesëdhjetë) **lekë pa TVSH**.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm përkatësisht për arsyet:

1. **Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “AIDA CONSTRUCTION” shpk**, me NIPT M03116403L & **“ROSI” shpk**, me NIPT J69102223E, me ofertë ekonomike në shumën prej **54,200,900** (pesëdhjetë e katërmilion dyqindmijë e nëntëqind) **lekë pa TVSH**, **nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat për kualifikim** të përcaktuara në dokumentat e tenderit **dhe Oferta e tij nuk është e vlefshme** për të kaluar në fazën e krahasimit dhe vlerësimit të ofertave, për të përcaktuar ofertën më të mirë, sipas kriterit “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim”, pasi ka këto mangësi në dokumentacionin e paraqitur:
- Anëtar i lider BOE “AIDA CONSTRUCTION” shpk (pjesëmarrës në raportin 79% sipas deklaratës së bashkëpunimit) nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.3.1. të Kapacitetit teknik, të Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, lidhur me punët e ngjashme të mëparshme. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE, rezulton se OE “AIDA CONSTRUCTION” shpk ka paraqitur kontratat me objekt: “Rikonstruksion i rrugës lidhëse Zharrëz – Shën Maria” e lidhur me shoqërinë “BANKERS PETROLEUM ALBANIA LTD” me vlerë 19,473,417 lekë pa TVSH dhe “Rikonstruksion dhe shtrim me asfaltobeton i rrugës Fshati i Ri – Sheqishte” e lidhur me Bashkinë Patos me vlerë 14,637,190 lekë pa TVSH. Referuar dokumentacionit shoqëruar të të dyja këtyre kontratave, si për datat e lidhjes së tyre, afatit të realizimit apo edhe investitorëve të ndryshëm, rezulton se ato janë kontrata të pavarura nga njëra-tjetra dhe nuk mund të paraqiten bashkarisht në formularin e vlerësimit. Sa më sipër, kontratat e ngjashme të paraqitura nga OE “AIDA CONSTRUCTION” shpk, nuk përmbushin asnjë prej kushteve të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës “2.3.1.”, sa i përket vlerës së kontratave të ngjashme të mëparshme, pasi kushti sipas shkronjës “a” *kërkon punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet*, ndërsa kushti sipas shkronjës “b” *kërkon “punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 180% i vlerës limit të*

kontratës që prokurohet, me vlerë të barazvlefshme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes në bashkim. Në nenin 83, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. [...]”.

Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga BOE “AIDA CONSTRUCTION” shpk & “ROSI” shpk, nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar sipas pikës 2.3.1. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit.

- Anëtari i BOE “ROSI” shpk (pjesëmarrës në raportin 21% sipas deklaratës së bashkëpunimit) nuk plotëson pikat 2.3.6. dhe 2.3.7. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi nuk ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit minimalisht 1 punëtor asfaltimi në rrugë dhe 1 mjet transporti me kapacitet mbajtës minimumi 18 ton, pasi për natyrën e punimeve që ka marrë përsipër të realizojë është e domosdoshme që shoqëria të ketë punëtor asfaltimi dhe mjet transporti me kapacitet mbajtës minimumi 18 ton. Në nenin 83, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. [...]”.

Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga BOE “AIDA CONSTRUCTION” shpk & “ROSI” shpk, nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara sipas pikave 2.3.6. dhe 2.3.7. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit.

2. Operatori Ekonomik (OE) “L.T.E CONSTRUCTION” shpk, me NIPT L78006801F, me ofertë ekonomike në shumën prej 53,880,430 (pesëdhjetë e tremilion e tetëqind e tetëdhjetëmijë e katërqind e tridhjetë) lekë pa TVSH, nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe Oferta e tij nuk është e vlefshme për të kaluar në fazën e krahasimit dhe vlerësimit të ofertave, për të përcaktuar ofertën më të mirë, sipas kriterit “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim”, pasi ka këto mangësi në dokumentacionin e paraqitur:

- OE “L.T.E CONSTRUCTION” shpk nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.3.6. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, lidhur me stafin mbështetës të kualifikuar, pasi referuar Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, rezulton se ka deklaruar vetëm 1 teknik ndërtimi ndërkohë që janë kërkuar 2 të tillë, si dhe nuk ka deklaruar asnjë teknik topograf.

Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga OE “L.T.E CONSTRUCTION” shpk nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar sipas pikës 2.3.6. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit.

- OE “L.T.E CONSTRUCTION” shpk nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.3.7. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, lidhur me disponimin e mjeteve dhe pajisjeve të nevojshme për

ekzekutimin e kontratës, pasi referuar Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë Rrul me peshë mbi 15 ton ndërkohë që janë kërkuar 2 të tillë.

Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga OE “L.T.E CONSTRUCTION” shpk nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar sipas pikës 2.3.7. të Kapacitetit teknik, të Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit.

3. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “TEA-D” shpk, me NIPT K32522629L & “COGREN” shpk, me NIPT J74818825K, me ofertë ekonomike në shumën prej 67,670,350 (gjashtëdhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë e treqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe Oferta e tij nuk është e vlefshme për të kaluar në fazën e krahasimit dhe vlerësimit të ofertave, për të përcaktuar ofertën më të mirë, sipas kriterit “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim”, pasi ka këto mangësi në dokumentacionin e paraqitur:

- BOE “TEA-D” shpk & “COGREN” shpk nuk plotëson Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi nuk ka paraqitur marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë. File (PDF) i ngarkuar në SPE me emërtim “Kontrate_bashkëpunimi_vendime” nuk ka ngarkesë, pra është 0 KB dhe nuk është i aksesueshëm, gjë e cila është në përgjegjësinë e BOE për të përgatitur dhe ngarkuar në SPE dokumentat përkatëse sipas formës dhe mënyrës së duhur. Te Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, është përcaktuar qartësisht se: *“Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet: - Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.”*

Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga BOE “TEA-D” shpk & “COGREN” shpk nuk plotësohen Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit.

- Gjithashtu, BOE “TEA-D” shpk & “COGREN” shpk nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.3.1. të Kapacitetit teknik, të Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, lidhur me punët e ngjashme të mëparshme. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE, rezulton se asnjë nga kontratat e paraqitura nuk është e ngjashme me punimet e kontratës objekt prokurimi dhe si të tilla nuk merren në konsideratë. Në këtë kuptim nuk përmbushet asnjë prej kushteve të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës “2.3.1.”, sa i përket vlerës së kontratave të ngjashme të mëparshme, pasi kushti sipas shkronjës “a” *kërkon punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet*, ndërsa kushti sipas shkronjës “b” *kërkon “punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 180% i vlerës limit të kontratës që prokurohet, me vlerë të barazvlefshme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes në bashkim.* Në nenin 83, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e*

tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. [...]”.

Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga BOE “TEA-D” shpk & “COGREN” shpk, nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar sipas pikës 2.3.1. të Kapacitetit teknik, të Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë (BOE): **“K.M.K” shpk**, me NIPT L78223801E & **“CAUSHI M” shpk**, me NIPT L88419801O, përfaqësuar nga “K.M.K” shpk, me adresë qendrore sipas QKB: Bulevardi “Rrapo Hekali”, Shkalla 1, Kati 1, Z.Kadastrale 1090, Ballsh, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **49,092,600** (dyzetë e nëntë milion e nëntëdhjetë e dymijë e gjashtëqind) **lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Mallakastër, me adresë lagjja “18 Prilli”, Ballsh, Mallakastër, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet siguri i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraprak)

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të Procedurës:

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Qerim Ismailaj